

**VENDIM**  
**Nr. 251, datë 8.10.2025**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISË “AGE ERZEN” SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR  
TRANSFERIMIN (NËPËRMJET BARRËSIMIT) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, germat “a” dhe “b”, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikave 1.3 dhe 1.6, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2026; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2430/3 prot., datë 3.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Age Erzen’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Age Erzen” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “Age Erzen” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 154, datë 31.7.2024, nga HEC “Hekali”.

- Shoqëria me shkresën nr. 2430 prot., datë 9.9.2025, ka paraqitur kërkesën për miratim në lidhje me barrësimin e kuotave dhe aseteve që i shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së licencuar të saj, për të përmbushur detyrimin ndaj “Banka OTP Albania” sh.a.

- ERE me shkresën nr. 2430/1 prot., datë 10.9.2025, i ka bërë me dije shoqërisë se kërkesa do të konsiderohet/regjistrohet si një aplikim kur është e shoqëruar me dokumentacionin përkatës në zbatim të rregullores nr. 119/2016, si dhe nëse asetet që shoqëria kërkon të transferojë i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, si dhe kanë vlerë më të madhe se 50,000,000 lekë (referuar nenit 4, germa “g”), si e tillë vetëm në këtë rast shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e kërkuar konform nenit 7, të rregullores nr. 119/2016.

- Me shkresën nr. 2430/2 prot., datë 22.9.2025, shoqëria ka përcjellë informacion /dokumentacion.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të neneve 2, germa “a”, 3, 5, germa “j” dhe 6, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, Përmbajtja e kërkesës për transferim:

Pika 1, Një përshkrim i të licencuarit që përmban informacion mbi:

- germa “d”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores, në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve;

- germa “h”: shoqëria duhet të depozitojë kontratën e kredisë me nr. 7825 rep., nr. 3593 kol., datë 9.9.2025, së bashku me listën e detajuar të aseteve fikse që kërkon të transferojë (me vlerat specifike dhe totale të tyre), listë e cila duhet të jetë pjesë përbërëse/integrale e kontratës dhe që t’i shërbejnë

veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, si dhe të ketë të parashikuar në të detyrimin për të marrë miratimin e ERE-s;

- germa “i”: shoqëria duhet të paraqesë deklaratën, që të shprehë gatishmërinë e bankës për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar, në rast të transferimit të aseteve;

- germa “j”: shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka pasur transferime të kryera më herët nga ana saj;

- pika 6: shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun, ndaj do t’i kërkohej ky informacion në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Age Erzen” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Bankës OTP Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë “Age Erzen” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**